



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1372_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2176_05_21 të dt. 28.05.2021**;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **02.07.2021**.

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.SH nga Komuna e Prishtinës, me shifër të konsumatorit DPR - 90060373, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2176_05_21, i datës 28.05.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 28.05.2021, ka marrë vendim me të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e konsumatorit A.SH nga Komuna e Prishtinës dhe është obliguar KESCO që ta anulojë korigjimin plotësues me nr.93574DPR – 90060373 të datës 10.12.2018 në vlerë financiare prej 1,656.31 EUR si dhe faturat e energjisë elektrike prej periudhës 03/2017 deri më 02/2018. Po ashtu është obliguar KESCO që konsumatorin A.SH për periudhën 03/2017 deri më 02/2018 ta faturoj bazuar në mesataren mujore të shpenzimeve për periudhën 03/2019 deri më 02/2020 ku TL = 753.92 kWh dhe TU=133.75 kWh.

Kundër këtij vendimi, në afatin ligjor ka paraqitur Kundërshtim i licencuari KESCO, për shkak se:

- ZRrE/DMK vendimin e saj e arsyeton në rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe në krahasimin e shpenzimeve me njehsorin e ri për periudhën pas ndërrimit të njehsorit dhe me periudhën para periudhës kontestuese, duke konstatuar se faturimi plotësues nuk përputhet me shpenzimet e mëvonshme me njehsorin e ri.
- Në procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit ka rezultuar se njehsori ka rezultuar me saktësi të matjes brenda kufijve të lejuar, por i njëjti e ka resetuar gjendjen e regjistruar, dhe në këtë rast regjistrimi i shpenzimeve nuk mund të konsiderohet i saktë.



- Periudha 03/2015 dhe 02/2016 është zgjedhur ka KESCO si periudhë krahasuese për faturim, sepse ishte periudhë me lexime të rregullta dhe e cila nuk ishte kontestuar asnjëherë për faturim.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2176_05_21 i datës 28.05.2021 për konsumatorin A.SH.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që DMK vendimin e saj e bazon në rrjedhën e energjisë aktive dhe në krahasimin e shpenzimeve, Bordi i ZRRE-së thekson se analizimi i rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe krahasimi i shpenzimeve të shpenzimit të energjisë është një nga provat më të rëndësishme në procedurën e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve në sektorin e energjisë, krahas provave tjera, pasi që na mundëson që të kemi një pasqyrë të qartë të profilin të një konsumatori ndër vite. Andaj, edhe në këtë rast, Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe ka konstatuar se korrigjimi i bërë nga departamenti i faturimit në KESCO nuk përputhet me shpenzimet e periudhave të mëvonshme me njehsorin elektrik nr.69675037 dhe mbi këtë bazë, DMK si shkallë e parë me të drejtë ka konstatuar se KESCO duhet ta faturojë konsumatorin bazuar në mesataren mujore të shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.69675037 për periudhën 03/2019 deri me 02/2020 prej TL=753.92 kWh dhe TU=133.75 kWh.

Lidhur me pretendimin se regjistrimi i shpenzimeve nuk mund të konsiderohet i saktë sepse njehsori e ka resetuar gjendjen e regjistruar të shpenzimit të energjisë elektrike, Bordi thekson se KESCO për periudhën 03/2017 deri me 02/2018 e ka ngarkuar konsumatorin me mesatarisht për muaj prej TL=1245 kWh dhe TU=800.17 kWh, ndërkaq shpenzimi me njehsorin elektrik nr.69675037 është disa herë më i ulët dhe nuk përkon me shpenzimin që është marrë për bazë nga i licencuari KESCO.

Andaj, duke u bazuar në nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: "1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim", Bordi ka arritur në përfundim se korrigjimi plotësues i kontestuar i dt. 10.12.2018 si dhe faturat e energjisë elektrike prej periudhës 03/2017 dhe 02/2018, duhet të anulohen si të tilla, sepse nuk përkojnë me shpenzimet reale të konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit A.SH. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar